

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarës H. D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.972/17 të datës 20.09.2017, gjatë shqyrtimit gjyqësor më datë **18.07.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Ismet Tofaj .përf. të autorizuar te dëmtuarës L. M. si dhe të akuzuarës mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **H. D.** nga Gjakova ,”...”, data e lindjes... ne Gjakovë ,e bija e H. dhe e nenës N. e gjinisë Sh.,ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, pensioniste ,e martuar – e shkurorëzuar, nënë e 1 fëmijë, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, ID

Bazuar në nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së:

REFUZHET AKUZA

Sepse :

- në mes te datës së pa vërtetuar e gjere me dt.**12.03.2016**, ne shtëpinë e saj ,me qellim qe vetit ti sjellë përfitim pasuror, ne mënyrë te kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike ashtu qe gjatë kontrollit është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr. 04657446,përmes kablllos 4x6 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik , kështu qe e ka pamundësuar regjistrimin e saktë te energjisë elektrike te shpenzuar e te dëmtuarës K. , i ka shkaktuar dem ne vlerë prej 718-45 euro., gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar te Distriktit ne Prishtinë me dt. 12.03.2016.

-me çka do te kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.972/17 të datës 20.09.2017, ka akuzuar të akuzuarën H. D. nga Gjakova ,për shkak te veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës, me propozimin që pas vlerësimit të gjitha provave të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor, e akuzuara të shpallet fajtores dhe te dënohet ne baze te ligjit .

E akuzuara H. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt.28.05.2018, duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet sipas aktakuzës. Në mbrojtjen e saj deklaroi se si ne shqyrtimin fillestar nuk e pranojë fajësinë për veprën penale me te cilën ngarkohem me qene se unë ne atë shtëpi kam qene me qira nga janari i vitit 2015 e gjere me dt.08.07.2016 dhe se gjendja është vërtetuar ne katin II-të ku unë nuk kam pasur qasje

fare ne atë pjesë te shtëpisë, shtojë se për energjinë elektrike te shpenzuar kam paguar ne mënyrë te rregullt faturat gjate asaj kohë sa kam qëndruar ne atë shtëpi me qira siç ka deklaruar edhe vete pronarja e shtëpisë ,e po ashtu ditën kritike kur kontrolli kanë gjetur gjendjen me ç ‘rast unë kam qene ne gatishmëri dhe iu kam ofruar ndihmë punëtoreve te K. et cilët kanë kërkuar mjete për thyerjen e murit e ku unë iu kam ofruar një tarrakop ,gjë qe e vërtetojë edhe dëshmitari M. K. ,e për këtë e kam informuar pronaren e shtëpisë përmes telefonit ,por e njëjta është përgjigjur se këtë e ka bere qiragjiu i mëhershëm qe ka shfrytëzuar shtëpinë dhe me ka thënë se nuk mund te jap emrin e tij se kam frikë për fëmijët .

Perf. i autorizuar i te dëmtuarës L. M. në këtë fazë te shqyrtimit gjyqësor deklaroi se pas dëgjimit te dëshmitareve dhe këtu mbrojtjes se te akuzuarës H. D. dhe nga provat ne shkresat e lendes kryesi i kësaj vepre penale nuk del te jete këtu e akuzuara H. D. si qiramarrëse por te gjitha dyshimet qojnë tek pronarja e shtëpisë E. S. , andaj ne këtë kuptim tërhiqem nga ndjekja penale respektivisht kallëzimi penale këtu e akuzuara H. D. me mundësi te ngritjes se një kallëzimi te ri penal ndaj pronares se shtëpisë E. S.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj bazuar ne deklaratën e dëshmitarit M. K. i cili u dëgjuar gjate këtij shqyrtimi deklaroi se muri ku është gjetur kablllo është shume i vjetër ,dhe është vendosur një kohë te gjatë para kontrollit ,si dhe mbrojtjes se te akuzuarës se me pronaren e shtëpisë kam biseduar te njëjtin ditë dhe e kam informuar për këtë gjendje ne prezencën e punëtorëve e ne telefon me është përgjigjur se këtë e paska bere qiramarrësi paraprakë si dhe bazuar ne tërheqjen e perf. të autorizuar të dëmtuarës ne këtë çështje penale juridike tërhiqem nga ndjekja penale ashtu qe propozoi qe pearf. i palës se dëmtuar te parashtrojë kallëzim te ri penal ndaj pronares se shtëpisë .

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit , Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P nr.611/17 të dt. 18.07.2018.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.